

MUHAMET MALA
MUHAMET QERIMI

PARAQITJA DHE SHTRIRJA E ETNONIMIT ARBËR, ARBANON NË BIZANT

Një nga problemet kryesore të historisë mesjetare shqiptare që është elaboruar shumë në historiografinë tonë dhe më gjerë është ai i paraqitjes dhe shtrirjes së emërimit arbanon gjatë periudhës bizantine. Kjo shtrirje përkon edhe me periudhën e dokumentuar në formën burimore nga autori bizantin Mihail Atataliati, i cili i përmend shqiptarët me emrin e tyre etnik, në përshkrimin e ngjarjeve të viteve 1040, 1043 e 1078¹.

Në trajtimin e problematikës së paraqitjes dhe shtrirjes së etnonimit arbanon njëra ndër pyetjet që shtrohet më shpesh për diskutim dhe që kërkon përgjigje më të saktë ka të bëjë me formën e emrit respektivisht me faktin se *a jan këta emra një krijim i ri apo një adoptim i emrit të vjetër Αλβανοί të përmendur nga Ptolomeu*². Paraqitjen mesjetare të emrit arbër në burime të shkruara mesjetare e hasim në format : *Αλβανον, Αοβανον, Albanum, Arbanum, e së këtejmi Αλβανοί, Αοβανίται dhe Αοβανιτών, si dhe në latinisht Abanenses, Arbanenses*.³ Gjatë kësaj periudhë shqiptarët e kanë quajtur veten e tyre *arbëneshë, larbëreshë*. Ndërkaq nga të huajt janë quajtur dhe vazhdojnë të quhën me trajta fjalësh, që lidhen me emrin e tyre të hershëm si në formën latine *arbanenses* apo *albanenses*, italiane *albanese*, greke *arvanitis*, sllave *arbanas* apo *raban* dhe *rabënëski*, si dhe turke *arnaut (arnavut)* etj. Të gjitha këto trajta e kanë burimin tek emërtimi më i hershëm i vetë vendbanimit të shqiptarëve *Arban/Alban* e që lidhet me emrin e fisit të lashtë ilir të Albanëve. Këtij emërtimi i është shtuar prapashtesa karakteristike e gjuhës me të cilën formoheshin emrat e banorëve të një vendi në gjuhën e huaj përkatëse⁴.

¹ Koço Bozhori, "Termet Albanoi dhe Arbanitei dhe përmendja e parë e popullit me të njëjtin emër në burimet e shek.XI", *Studime historike*, nr.4, Tiranë: 1974, f. 188.

² Thoma Kacori, "Kontribut për studimin e prejardhjes së emrave AJIBANOI dhe AJIBANOΠΟΛΙΣ", *Studime historike*, nr.1-2 Tiranë: 1988, f.145; krahaso Eqrem Çabej në *Studime etimologjike në fushë të shqipes Bleu, II A-B*, Tiranë: 1976, f. 61-69.

³ *Po aty*.

⁴ Shaban Demiraj, "Emërtimi i shqiptarëve ndër shekuj", në *EKSKLUZIVE*, nr. 23/ 2002, f. 84.

Sa u përket termave Albanoi, Arbanitai dhe Komiskortë etj., në historiografi janë shtruar teza të ndryshme shpesh kundërthënie. Kështu bizantologia greke Era Vranusi i hedh në diskutim dhe i kundërshton, por tezat e saj hedhën poshtë në mënyrë të argumentuar dhe shkencore autorë të vendit dhe të huaj si: Koço Bozhori⁵, Thoma Kacori⁶, Eqrem Çabej⁷, Alian Ducellier⁸ etj., duke potencuar se përhapja e emrit kombëtar Arbër (Arbëri/Albani) është e lidhur ngushtësisht me hapësirën gjeografike të banuar nga shqiptarët gjatë mesjetës⁹. Ndërsa studiuesi i njohur Eqrem Çabej ka theksuar se “vendbanimi i sotëm i shqiptarëve nuk është një trevë ekspansioni por trevë restriksioni, përfundim i një ngushtimi të paprerë gjatë historisë shqiptare¹⁰. Çabej vë në dukje se që moti në atdheun e shqiptarëve kanë bërë pjesë viset bregdetare që nga Ragusa deri në Artë¹¹. Gjatë periudhës në studim “krahinat përgjatë rrugës së rëndësishme Nish – Shkup – Manastir – Kostur – Janinë - Artë kanë qenë të banuara gjatë mesjetës kryesisht nga shqiptarë dhe formonin kufirin lindor deri ku shtriheshin viset etnike shqiptare.¹²

Në sqarimin e problematikës në fjalë pa dyshim se burimet historike bizantine janë më të rëndësishmet. Ato përmbajnë njoftime mbi viset shqiptare dhe shqiptarët si dhe janë të shumëllojshme. Nëpërmjet tyre është hedhur dhe vazhdon të hidhet dritë mbi historinë politike e kishtarë të shqiptarëve. Në tërësinë e këtyre burimeve bizantine përfshihen: kronika; dokumente dhe akte zyrtare të perandorëve, institucioneve shtetërore dhe kishtarë; fjalime e ligjërata politike; monumente ligjore; manuale ushtarake; jetëshkrime shenjtorësh etj. Nëse do të bënim një klasifikim të tyre mund ti ndajmë në: burime dokumentare dhe burime tregimtare.

Përgjithësisht, burimet bizantine kanë pasur dhe kanë një rëndësi shumë të madhe për historiografinë shqiptare. Jashtë përdorimit të tyre nuk mund të pretendohet të ndërtohet historia mesjetare shqiptare e periudhës paraosmane.

⁵ K. Bozhori, *art. i cit.*; “Kritikë e Bibliografi”, në *Studime historike*, nr. 3, 1964 etj.

⁶ K. Kacori, *art. i cit.*

⁷ E. Çabej, *art. i cit.* etj.

⁸ *Përpyekja e re rreth shfaqjes së popullit shqiptar në burimet historike bizantine*, Tiranë: 1972 dhe studime të tjera.

⁹ Kasem Biçoku, “Viset etnike shqiptare në mesjetë dhe përhapja e emrit kombëtar Arber, Albani”, *Studime historike*, nr. 1-4, Tiranë, 1995, f.27.

¹⁰ Eqrem Çabej, “Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve”, *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, nr.2, Tiranë, 1958, f.54-67; K. Biçoku, *art. i cit.*, f.27.

¹¹ Eqrem Çabej, *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin e Ballkanit në dritën e gjuhës dhe të emrave të vendeve*, Tiranë: BUSHT, 1962/1, f.219-226; K. Biçoku, *art. i cit.*, f.27.

¹² K. Biçoku, *art. i cit.*, f.28.

Ato, në disa raste janë edhe të vetme për të shpjeguar historinë e popullit shqiptar dhe të territoreve të banuara prej tij.

Vendi i veçantë që zënë burimet bizantine shpjegohet me faktin se viset shqiptare kanë bërë pjesë në Perandorinë Bizantine qysh nga fillimet e saj. Ndaj nuk është rastësi që njoftimet e para dhe të rëndësishme për shqiptarët dhe vendbanimet e tyre në mesjetë vijnë nga këto burime.

Në studimet historiografike shqiptare dhe të huaja ka zënë një vend të konsiderueshëm edhe çështja se kur shqiptarët janë shfaqur për herë të parë në trojet që edhe sot banohen prej tyre dhe cila ishte shtrirja e tyre.

Nga disa studiues kjo çështje është trajtuar si një "...nga problemet më të mprehta dhe më të pazgjidhura që shtrohen për Ballkanin mesjetar".¹³

Grupi i autorëve që mbrojnë pikëpamjen e problemit të pazgjidhur lidhur me këtë çështje marrin si pikë referimi burimet e pamjaftueshme historike. Këto sipas tyre janë "...të rralla e të paqarta" dhe si të tilla kanë shërbyer si burim për "...hipoteza të panumërta, nga të cilat... asnjëra nuk është bindëse për... përcaktimin sa më të saktë... të krahinës që autorët bizantinë e quanin...Arbanon".¹⁴

Disa studiues e kanë kërkuar zanafillën e trajtimit të këtij problemi qysh në shek. e II pas Krishtit¹⁵. Ata mbështeten në plan të parë në njoftimin e lënë nga gjeografi dhe astronomi Aleksandrian Klaud Ptolemeu që i përket këtij shekulli. Njoftimi i tij konsiston në praninë e fisit ilir me emrin "Alban" dhe kryeqendrës së tij "Albanopolis",¹⁶ si pjesë përbërëse e provincës romake të Maqedonisë, me vendosje në hapësirën midis Durrësit dhe Ohrit¹⁷. Mandej deri në mesin e shekullit të XI emri *Alban* nuk përmendet më direkt si emër i popullsisë Arbërore. Por fakti që Arbanonin, sipas burimeve historike e gjejmë në ato vise që ishin të banuar nga albanët rreth nëntë shekuj më parë, mendohet se nuk ka qenë një rastësi.¹⁸ E përgjithshme është se vazhdimësia nga ilirët te

¹³ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A. II. 67, Alian Ducellier, "Arbanoni dhe shqiptarët në shek. XI", fl. 1.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ Pëllumb Xhufi, "Vëzhgime mbi emrin Shqipëri dhe shqiptarë në mesjetë", *Studime historike*, 3-4/2001, f. 12; Edwin Jacques, *Shqiptarët / Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Tiranë: "KARTË E PENDË", f. 183; Ludwig Von Thalloczy-t, *Vëzhgime Iliro-Shqiptare*, Shkodër: "Camaj-Pipaj", 2004, f. 67.

¹⁶ *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, Tiranë: 2002, f. 268; C. Muller, *Claudi Ptolomaei Geographia*, vol. I, Paris 1883, lib. III, 20; E. Jacques, *vep. e për.*, f. 183.

¹⁷ Koço Bozhori, "Vëzhgime rreth shtrirjes së emërtimit arbanon në kohën bizantine", në *Studime historike*, nr. 4/1972, f. 135.

¹⁸ Skënder Anamali, "Nga ilirët tek arbërit", në: *Kuvendi I i studimeve ilire*, Tiranë, 1974, f. 41.

shqiptarët është pranuar nga ballkanologët,¹⁹ andaj “ai që studion çështjen e prejardhjes së emrit Αλβανί nuk duhet të harrojë se këta përmenden në burimet historike si banorë të Ilirisë”²⁰. Megjithatë kjo zbrazëti ka qenë dhe mbetet një problem i historiografisë.

Pavarësisht prej mungesës së burimeve, në studimet historike është shprehur dhe mendimi se termat Arbëri dhe Arbëresh duhet të jenë njohur e të jenë përdorur edhe para M.Attaliate dhe se ato e kanë burimin tek fisi ilir i albanëve. Njëri nga bizantologët më të njohur shqiptar pohon se “në nivelin e sotëm të njohurive nuk ka dyshim, se çdo diskutim për emrin mesjetar të shqiptarëve duhet të fillojë me dëshminë e Ptolemeut”²¹.

Në ndihmë të këtij përfundimi vijnë edhe njoftimet apo burimet e natyrës kishtarë. Këto njoftime janë trajtuar në një studim të autorit Jerasimos J. Konidharis²². Ai, duke shfrytëzuar librin e famshëm që u kushtohet biografive të shkurtra papale (Libër pontificalis) ndeshi me përdorimin e emrit “Albanos”, për papën e 41, Inocenti I (ushtroi detyrën papale në vitet 402-417), e shprehur në formën “*Innocentini nationale albanesi*”²³.

Duke interpretuar me shumë kujdes përdorimin e termit “*Albanesis*” të përmendur në librin pontificalis, vërehet se në këtë libër përgjithësisht është përcaktuar kombësia e papëve, prejardhja provinciale apo qytetare e tyre. Kjo mënyrë të trajtuari në të shkruar ka qenë shumë karakteristike për periudhat e lashtësisë dhe sidomos për ato perandorake.²⁴

Meqenëse redaktorët e libër pontificalis, për përcaktimin e prejardhjes së papëve kanë përdorur herë qytetin, herë provincën (krahinën) dhe herë kombësinë e tyre lind e drejta për të bërë interpretimet e mundshme në përputhje me logjikën historike të trajtimit të problemit. Shtrohen dy variante: bëhet fjalë për një Alban që mund të ketë qenë nga Italia ose për një Alban prej Ilirie. Për të hedhur dritë mbi njërin ose tjetrin variant e pamë të nevojshme ta analizojmë problemin në kuadrin e përgjithshëm historik të kohës. Burimet historike hedhin dritë mbi faktin se Inocenti ishte themeluesi kryesor i Vikariatit të Selanikut²⁵. Si i tillë dhe nga ky moment, Inocenti, krahasuar me paraardhësit e tij, shfaqti mjaft ndryshime në politikat kishtarë. Ai i dha kryepeshkopit të Selanikut më shumë të drejta, si dhe shpalli ekzarkun e

¹⁹ Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë: “Dituria”, 2002, f. 19.

²⁰ Th. Kacori, *art. i cit.*, f.139.

²¹ P. Xhufi, *art. i cit.*, f. 8.

²² *AIH*, A.II.64, Jerasimos J. Konidharis, “Rreth përmendjes së parë të shqiptarëve në burimet kishtarë dhe kufijtë e vendit të tyre në kohën e bizantit”, fl. 1-2.

²³ *Po aty*, A. II. 67, A. Ducehier, *burim i përm.*, fl. 1.

²⁴ *Po aty*, A. II. 64, J. Konidharis, *burim i përm.*, fl. 4-5.

²⁵ *Po aty*, fl. 5.

Ilirikut. Ka shumë të ngjarë se Inocenti, që i kushtoi vëmendje të veçantë Ilirikut të ishte nga Iliria²⁶.

Ky përfundim përgjithësisht nuk ka gjetur mbështetje në kritikën historiografike. Nga disa autorë është vlerësuar si një trajtim i njëanshëm, ku merret parasysh vetëm aspekti gjuhësor, ndërkohë që sipas tyre mungojnë të dhëna të tjera për të krijuar një terren më bindës për idenë e hedhur nga Konidharis. Autori Alian Ducellier²⁷, që ka kundërshtuar idenë e Konidharisit, i përmbahet mendimit se argumenti i përmendur “nuk lejon aspak të pohosh që Inocenti të ketë qenë me kombësi arbërore”, përderisa ka “mungesë të ndonjë argumenti tjetër”. Po ky autor pohon se “deri në shekullin e XI... nuk njihej asgjë për një njësi gjeografike të quajtur Albanie”. Edhe pse pranon ekzistencën e një peshkopate në Krujë, nuk e konsideron këtë qytet si “qendër të banimit shqiptar”²⁸. Megjithatë ne mendojmë se Izopolitia²⁹ e përmendur në burimet bizantine paraqiste një formë shumë të hershme të njësisë politike autonome të arbrit brenda Perandorisë Bizantine e shënuar pikërisht në territorin gjeografik ku gjatë antikes shtrihej fisi ilir i Albanve dhe që përmendet nga Ptolomeu.

Ne do ta vlerësojmë të dhënën e fillimit të shekullit të V për papën Inocenti I, e shprehur në formën “Innocentin nationale albanesi” si mjaft interesante. Përderisa në mendimin historiografik është pranuar ekzistenca e fisit të albanëve në shek. e II sipas njoftimit të Ptolemeut, nuk mund të ndodhte që ky emër të kishte një jetëgjatësi të shkurtër. Ai natyrisht ka patur mbijetesën e tij edhe në kohra të mëvonshme. Në këtë këndvështrim i përmbahemi pikëpamjes se edhe të dhënat e natyrës kishtarë që u përmendën më lartë i dedikohen një pape nga krahina e Albanoit që shekuj më vonë do të prezantohet në formën Arbanon. Kjo ide ka gjetur dhe mbështetjen e Konidharis kur shprehet se “është hera e dytë që bëhet fjalë për *albanë* ose për komb shqiptar”³⁰. Termin *albanesi* të përmendur në fillim të shekullit të V e vlerësojmë si një nyjë lidhëse midis *albanoi* të Ptolemeut dhe *albanoi* dhe *Arbanitai* të M. Attaliate që i përkasin shek. XI.

Duke pranuar për të vërtetë prejardhjen arbërore të Inocentit I atëherë arrijmë edhe në përfundimin tjetër se krahina e prejardhjes së tij ishte në veri të lumit Shkumbin, trevë kjo, epiqendër e formimit të kombësisë arbërore-shqiptare dhe që kishte për qendër qytetin e Krujës, dhe që në shek. XI del si qendër peshkopale.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ *Po aty*, A. II. 67, A. Ducelier, *burim i për.*, fl. 2.

²⁸ *Po aty*, fl.1.

²⁹ M. Attaliate, *Historia*, Bonnae, 1853, f.9; Sipas Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Tiranë: 2006, f.53.

³⁰ *AIH*, J. Konidharis, *burim i për.*, fl. 5.

Kjo e dhënë dhe kjo mënyrë e të trajtuari mendojmë të jetë një shkëndijë kundër atyre pikëpamjeve që kanë “vënë në pikëpyetje edhe probleme të tilla , siç është autoktonia dhe vazhdimësia iliro-shqiptare”³¹. Gjithashtu mendojmë se vihet seriozisht në pikëpyetje teza e hedhur nga një pjesë e madhe e studiuesve të mesjetës, se emri “Albanoi” u zhdruk për shekuj të tërë për të dalë përsëri si papritmas në dritë në shek. XI mendim ky që ka dominuar dhe vazhdon të jetë ende prezent në historiografi.

Gjatë shekujve të mesjetës burimet bizantine janë dominuar prej terminologjisë administrative. Sipas saj, popujt e krahinave të ndryshme përgjithësoheshin me emrin e qendrës administrative (themës). Në këtë rrafsh duhet përmendur autori bizantin i shek. X, Kostantini VII Porfyrogjeneti, i cili pjesën më të madhe të iliro-arbërve i përfshin me termin “Durrës”, që nënkupton themën bizantine me të njëjtin emër, krijuar rreth fillimit të shek. IX e që përfshinte tokat prej Tivari në Himarë³². Sipas dëshmisë të priftit të Dioklesë banorët e themës së Durrësit thirreshin “durrsakë” (*durraceni*)³³. Durrësi dhe Arbëri bashkëjetonin në një partneritet të përsosur dhe jo rastësisht emri i Arbërit shoqëron, e nganjëherë zëvendëson atë të Durrësit në emërtimin zyrtar të temës³⁴. Në thelb nuk kemi të bëjmë thjesht me një çështje emërtimi, por me zhvillimin e faktorëve të brendshëm të themës që lëvizin në mënyrë progresive në favor të Arbërit. Midis Durrësit dhe Arbërit pati një bashkëjetesë të ngushtë, e cila u shoqërua me një proces të dyfishtë: me arbërizimin e Durrësit bizantin e të institucioneve të tij dhe me bizantinizmin e arbërit.

Krahas emërtimit të popullatës sipas emrit të qendrës së provincës ndeshet edhe emërtimi sipas pushtuesit. Në kronikat bizantine që i përkasin periudhës së pushtimit bullgar, hapësirat e Arbërisë dhe Epirit quhen me emrin Bullgari³⁵.

Pas njoftimit të shek. V shqiptarët përmenden në burimet historike mesjetare me emrin e tyre etnik në formën *albanoi* dhe *Arbanitai* nga historiani

³¹ G. Weigand, “Sind die Albaner die Nachkommer der Illyrier oder der Thraker”, në *Balkan Archiv*, III, Band, Leipzig, 1927, f. 242; G. Shtatmyler, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, bot.II, Wiesbaden: 1966, f. 38-46. Sipas P. Xhufi, “Vëzhgime mbi emrin Shqipëri ...”, f. 7.

³² *AIH*, A.II.88, K. Jireček, “Tema Bizantine ...”, fl. 1.

³³ F. Šišić, *Letopis Popa Dukljanina*, Beograd-Zagreb: 1928, f. 353.

³⁴ Th. Tafel-G.Thomas, *Urkunden zur älteren Handels-und Staatsgeschichte der Republik Venedig*, I, Band, Wien: 1856, f. 472, 491; P. Schreiner, “Der Dux von Dalmatien und die Belagerung Anconas im Jahre 1173”, në: *Byzantion*, vëll. 41, 1971, f. 287; Pëllumb Xhufi, “Ndarja e Shqipërisë nga Bizanti”, në: *Studime historike*, nr. 1-2/1999, f. 28.

³⁵ *AIH*, A.II.88, K. Jireček, “Tema Bizantine...”, fl. 4.

bizantin i shek. XI, M. Attaliate³⁶. Ai ishte pjesëmarrës në kryengritjen e gjeneralit Georgios Maniakes që u zhvillua në vitin 1043 dhe në kryengritjen e dukës Nikeforos Basilakios që shpërtheu në vitin 1078 dhe që pjesërisht u zhvilluan edhe në territoret shqiptare³⁷. Arsyeën përse *albanitët* apo *arbanitët* përmenden për herë të parë në vitin 1043 e gjejmë tërthorazi tek vetë M.Attaliate.

Ai duke përshkruar kryengritjen thotë se ushtria bizantine përveç elementesh të tjerë kishte edhe “shumë romakë, bullgarë dhe *arbanitë*”. Sipas tij *albanitët* dhe latinët ishin shtetas të barabartë të perandorisë dhe “kishin një besim... dhe po ato të drejta civile që kishin edhe bizantinët”³⁸, por pastaj u bënë në mënyrën më të çuditshme armiq të tyre³⁹. Po sipas njoftimeve të M.Attaliate *arbanitët* në vitin 1043 kishin reparte ushtarake të veçanta nga ato bizantine, si dhe një prijës të dalë nga gjiri i tyre. Kjo e dhënë plotësohet edhe me “praninë e shqiptarëve në gjirin e hierarkisë bizantine”. Kjo e fundit dëshmohet prej pranisë së dy princërve që mendohet se i përkasin familjes së famshme të Arianitëve⁴⁰. I pari përmendet nga Skilices - Kedrenosi në kuadrin e operacioneve të Bazilit II kundër Samuelit në vitin 1001, me emrin David Arianiti,⁴¹ ndërsa i dyti përmendet si nga M.Attaliate dhe Skilices - Kedrenosi në kuadrin e fushatës së vitit 1050 drejtuar nga Kostandini IX kundër peqenëgëve dhe mbante titullin e magjistrisë e që saktësohet me emrin Konstantin Arianitisi⁴².

Pra, këto njoftime kanë rëndësi “jo vetëm se i përmend shqiptarët me emrin e tyre etnik, por edhe për faktin që... i përmend si pjesëmarrës aktiv në jetën politike të Perandorisë Bizantine”⁴³.

Sipas A.Dycellier termat *albanoi* dhe *Arbanitai* përkojnë në kohë “me evolucionin shoqëror të epokës, me kalimin në stadin feudal”. Në këtë kohë ai

³⁶ M. Attaliate, *vep. e përm.*, f. 9, 18; Sipas K. Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes së emërimit Arbanon në kohën bizantine”, *Shqiptarët dhe trojet e tyre*, Tiranë, 1982, f. 185.

³⁷ M. Attaliate, *vep. e përm.*, 9,9; 18,17; 297,21. Sipas Kristo Frashëri, “Trojet shqiptare në shek. XV”, *Shqiptarët dhe trojet e tyre*, Tiranë, 1982, f. 200.

³⁸ *AIH*, A. II. 67, A. Ducelier, *burim i përm.*, fl. 4.

³⁹ M. Attaliate, *vep. e përm.*, 9,9; sipas Kristo Frashëri, “Trojet Shqiptare në shek.XV”, *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike*, Tiranë, 1969, f 110.

⁴⁰ *AIH*, A. II. 67, Alian Ducelier, *burim i përm.*, fl. 7.

⁴¹ Skylitzes-Kedrenos, II, Bonnae 1839, f.454; Sipas P.Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, f.76.

⁴² *AIH*, A. II. 67, Alian Ducelier, *burim i përm.*, fl.8.

⁴³ Koço Bozhori, Filip Liço, *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë (shek X-XV)*, Tiranë, 1975, f. 45; Dhimitër Shuteriqi, “Aranitët – Zotërimet”, *Studime historike*, nr.1, Tiranë, 1967, f 59.

gjen edhe “bashkëpunimin e aristokracisë shqiptare me pushtetin perandorak”⁴⁴. Ky autor duke interpretuar të dhënat e Ataliatit konkludon se emri “albanoi” është përdorur për të treguar “... një popull të ndryshëm nga latinët, më afër Bizantit dhe që merr pjesë në botën e tij politike dhe fetare” dhe si zgjidhje më e evidente e më të pranueshme ai merr guximin shkencor të pohojë që “albanoi” e M.Attaliatit janë shqiptarë⁴⁵. Në ndihmë të kësaj ideje, sipas tij vjen edhe fakti që “shqiptarët e vitit 1040 ishin të vendosur nën kryetarin e tyre”⁴⁶, gjë që e konsideron si element të qenies së tyre me statusin e aleatit dhe jo të mercenarit.

Nëpërmjet interpretimit të dhënave të përmendura nga disa autorë është trajtuar ideja se “shqiptarët në mesin e shek. XI jetonin në lidhje të ngushtë me popullsitë fqinje”⁴⁷. Kjo do të thotë se albanitët në vitin 1043 në dallim nga periudha e më hershme tani, nuk ishin as shtetas bizantinë dhe as ndjekës të ortodoksisë, pra nuk kishin të përbashkët me bizantinët as komunitetin politik dhe as atë fetar. Si të tillë nuk mund të quheshin “romaios” dhe pikërisht ishin këto rrethana që në dokumentacionin e kohës mundësuan të depërtojë emri *albanit*.

Këto fakte dhe trajtimi i tyre në historiografi kanë ndeshur edhe në ide kundërshtuese. Studiuesi A. Dycellier duke përjashtuar idenë se arbërit ishin një popull i tërhequr në krahinat e thella të Matit dhe nuk mund të kishin elementë të qytetëruar sa të shikoheshin si të barabartë me latinët e Italisë bizantine dhe vetë bizantinët⁴⁸ mbështetet tek përfundimi i Shtadmylerit, i cili i vendos arbanitët “në rrethinat e Durrësit” dhe duke u nisur nga këtu mbron pikëpamjen se prej “mesit të shekullit të XI, shqiptarët ishin një popullatë mjaftë e njohur nga bizantinët dhe jetonin sigurisht jo shumë larg Durrësit”⁴⁹. Shtrirja e arbrit nuk të krijon përshtypjen e një shpërthimi të shpejtë e të papritur demografik të tyre përtej kufijve të ngushtë.

I njëjti autor (Attaliatë) na njofton tri dekada më vonë (1078) për veprimin e reparteve ushtarake *arbanite*⁵⁰. Dycellier, duke bërë krahasimin me termin e përdorur në vitin 1043, i përmbahet mendimit se edhe ky term ka “një kuptim të pastër etnik” dhe se këtu kemi të bëjmë me faktin që etnonimi “arvanitoi” nënkupton popullin në përgjithësi dhe jo një fis apo kategori

⁴⁴ A. Ducellier, “Përpjekja e re rreth shfaqjes së popullit shqiptar në burimet historike bizantine”, *Kuvendi i studimeve ilire*, Tiranë, 1972, fl. 3-4.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 12.

⁴⁶ *Po aty*, fl.13.

⁴⁷ *AIH*, A. II. 67, A.Ducellier, *burim i përm.*, fl.6.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 5.

⁴⁹ *Po aty*, fl. 8-9.

⁵⁰ M. Attaliatë, *vep. e përm.*, 297,21; J. Skylitzes, Bonn, 1839, II, 739,9; Sipas K. Frashëri, “Trojet shqiptare...”, f. 201.

njerëzish, të futur në shërbim të dikujt tjetër⁵¹. Pavarësisht nga ndryshimet, përdorimi i dy termave nga Mihail Ataliatit, në shek. e XI, sipas A. Dycellier tregojnë “të njëjtin popull”. Për të “çdo interpretim tjetër... është absurd dhe... pa baza”⁵².

Problemi rreth termit Arbër bëhet më i qartë tre vjet më vonë. Më konkretisht në tetor të vitit(1081)⁵³ historiania bizantine Ana Komnena, përmend emrin në formën “Arbanez”⁵⁴ për popullsinë që ndodhej pas Durrësit, gjatë disfatës që perandori bizantin Aleks I pësoi në një zonë në jug të Durrësit. Njoftimi i autores në fjalë plotësohet dhe nga një e dhënë tjetër. Sipas saj, pas disfatës pjesa e sipërme e qytetit të Durrësit iu besua venedikasve, kurse pjesa tjetër iu besua një personi me origjinë shqiptare⁵⁵, zëvendës i strategut të themës së Durrësit. Ai mbante titullin “komeskortes” dhe kishte një pozitë të pavarur politike ndaj Kostandinopojës, përderisa perandori bizantin Aleks Komneni hyri në marrëveshje me të, njësoj si me princat e pavarur të Duklës e të Dalmacisë, për të luftuar bashkërisht si aleatë kundër normanëve⁵⁶.

Një njoftim tjetër që i përket fillimit të shek. XII tregon se normanët, në Këngën e Rolandit, në gjuhën frënge, e quanin krahinën nga Durrësi në Vlorë “Albania”⁵⁷. Njoftimi i Komnenës, si dhe të tjera të kësaj natyre janë vënë shpesh në diskutim nga historianët grekë. Historiana Era L. Vranasis është përpjekur të provojë se në këtë rast nuk bëhet fjalë për një shqiptar, por për një funksionar bizantin të vendosur në krye të një krahine të panjohur me emrin Arbanon.⁵⁸ Është për tu theksuar se këtu studiuesja Vranasis bënë edhe një gabim metodologjik ku nga një e panjohur(e pasqaruar) nxjerr edhe një të panjohur tjetër.

E rëndësishme është se në burimet bizantine gjenden të dhëna që hedhin dritë mbi faktin se ilirët dhe arbërit (shqiptarët) janë i njëjti popull. Këtë gjë na e thotë shumë fuqishëm Kronisti bizantin Niqifor Brieni i cili, gjatë kronikave të tij përdor edhe termin ilir dhe atë shqiptar⁵⁹. Kjo tregon se ai me njohuritë që dispononte kishte arritur në përfundimin se në të dyja rastet kishte të bënte me të njëjtin popull.

⁵¹ *AIH*, A. II. 67, A. Ducelie, *burim i përm.*, fl. 5.

⁵² Po ai, “Përpjekja e re rreth shfaqjes...”, fl. 6.

⁵³ *AIH*, A. II. 67, Po ai, “Arbanoni dhe Shqiptarët...”, fl.9.

⁵⁴ E. Jacques, *vep. e përm.*, f. 183.

⁵⁵ *AIH*, A. II. 67, A. Ducellier, *burim i përm.*, fl. 9.

⁵⁶ *Anna Komnena*, Leipzig, 1884, IV,8; VI,7; Sipas K. Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes...”, f. 201; po ai, “Kritikë e Bibliografi ...”, f.183-188.

⁵⁷ E. Jacques, *vep. e përm.*, f. 183.

⁵⁸ *AIH*, A. II. 67, A. Ducelie, *burim i përm.*, f. 9.

⁵⁹ Koço Bozhori - Filip Liço, *Burime tregimtare bizantine...*, f. 59.

Mbështetur në interpretimin e këtyre të dhënave, në mendimin historik ka lindur dhe është zhvilluar pikëpamja se “emri i arbanëve u përdor që nga shek. XI për të karakterizuar stërnipërit (pasardhësit) e ilirëve të lashtë”⁶⁰.

Por, edhe autori në fjalë (Dyceller) që është pro tezës së pranisë së shqiptarëve nuk u jep atyre shtrirjen reale. Ai i përmbahet mendimit se “Arbanoni nuk mund të shtrihej aspak përtej një kufiri jugor të vendosur mbi rrjedhën e Devollit”⁶¹.

Sikundër shihet në një pjesë të trevave shqiptare (Arbanon) po zhvilloheshin tendenca decentralizuese të karakterit politik dhe fetar. Treva e Arbanonit ishte dhe një dioqezë kishtare që mbante emrin e kryeqendrës së saj – Krujës (Peshkopata e Krujës), e cila ishte krijuar sipas traditës në fillim të shek. VII⁶². Kur treva e Arbanonit kaloi nga pikëpamja fetare në anën e Romës, me peshkopatën e Krujës u bashkuan dhe peshkopatat fqinjë të Lisit (që shtrihej në Mat e Mirditë) dhe ajo e Stefaniakës (në krahinat e Tamadhesë e të Bendës), duke formuar dioqezën e Arbanonit, *dioceseos arbanensis*⁶³. Këtyre situatave dhe zhvillimeve u duhet shtuar dhe kriza që po përjetonte Perandoria Bizantine në këto kohëra. Ishin këto zhvillime që nxorën në dritë termin albanoi me origjinë historike, si dhe termin arbanitai me karakter etnografik (nga emri i krahinës). Pra, këto terma u përdorën për pjesëtarët e komunitetit politik e fetar që po krijohej rreth e rrotull krahinës Arbanon. Këto depërtime, në mendimin historiografik janë trajtuar si “jashtë të qenit një emërtim etnik” dhe se ato nuk janë “përdorur për të përkufizuar gjithë popullsinë ilire, por vetëm popullsinë katolike të rajonit Arbanon”⁶⁴.

Duket se ka një mungesë të ndjeshme të të dhënave kishtare. Kjo, edhe për faktin që dëshmohej nga statistikat kishtare, se prej fundit të shek. IX për shkak të invazionit bullgar “u shkatërruan të gjitha episkopatet e mitropolisë së Durrësit”⁶⁵. Nuk përjashtohet mundësia që ky invazion të jetë shoqëruar me shkatërrime dhe humbje masive të dokumentacioneve që mbartnin qendrat e ndryshme peshkopale.

Krahas emrit Arbanon, burimet historike japin njoftime mbi përdorimin edhe të emrave Ilirë dhe Iliri edhe pas shek. të dytë, madje edhe pas shek. të XI-XV, kur emri Arbanon, jo vetëm kishte filluar të përdorej, por edhe ishte afirmuar. Megjithatë përdorimi i emrit ilir ishte dukshëm më pak në përdorim për shqiptarët gjatë mesjetës krahasuar me emrin arbër respektivisht arbanon. Kuptohet tanimë se emri kombëtar mesjetar arbër e Arbëri (Albani) është

⁶⁰ AIH, A.II.64, J. Konidharis, *burim i përm.*, fl. 6-7.

⁶¹ *Po aty*, A.II.67, A.Ducellier, *burim i përm.*, fl 4.

⁶² K. Frashëri, “Trojet shqiptare...”, f. 202.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ N. Bozborra, *vep. e përm.*, f. 19.

⁶⁵ AIH, A.II.64, J. Konidharis, *burim i përm.*, fl. 19.

trashëguar nga onomastika ilire dhe si i tillë na paraqitet në krahinat jugore të Ilirisë së dikurshme. Por ajo që vlen të theksohet në këtë rast është fakti së gjatë mesjetës emri Arbanon paraqiste vetëm një formë të fragmentarizuar të konceptit më të gjerë etnik ilir. Madje konceptin ilir e gjejmë të fragmentizuar jo vetëm në formën arbër arbanon por edhe në forma të tjera përmes konceptit, epirot,⁶⁶ dardan madje edhe maqedon edhe kur këto koncepte pushojnë se ekzistuari si etnos. Pas stabilizimit të dyndjeve sllave në Ballkan emri Iliri mbeti më tepër si koncept i përgjithësuar që përfshinte territoret e Ilirisë të banuara tani nga popuj sllav jo ilir. Ndërkaq Emri Alban, Arbanon, Arban më vonë edhe Epirot gjeti përdorim në viset ku u krijua etnosi shqiptar i mesjetës. Kjo situatë nuk nënkuptonte assesi faktin se koncepti ilir nuk kishte të bënte me shqiptaret por si duket koncepti Alban në mesjetë e më vonë edhe Epirot gjeti përdorim më të gjerë si emërtim për shqiptarët për faktin se të dy këto fise gjeografikisht shtriheshin apo ishin më afër territorit ku historikisht evidentohet ruajtja e popullsisë së lashtë ilire që përmes kronistëve bizantin nga shek.XI tutje siç u theksua do ta quajnë me emrin Albanoi,Arbanitoi (Arbër).

Tërësia e burimeve të përmendura kanë qenë dhe vazhdojnë të mbetën objekt trajtesash deri dhe në studimet serioze të fushës së historisë, gjuhësisë etj. Në to ka mbizotëruar mendimi se “*lidhja e emrit Arbën (ë)/ Arbër (ë) me etnonimin Albanoi është plotësisht e mundshme si historikisht dhe gjuhësisht*”⁶⁷.

Pra, këto burime, si dhe emëruesi i përbashkët i shumë autorëve në interpretimin e tyre, krijojnë situata për të mbrojtur shkencërisht pikëpamjen se emërtimi albanon ka që në origjinë një përmbajtje etnike. Por deri tani ende është i pa qartësuar mirë problemi se në cilën kohë termat Arbëri dhe arbëreshë fituan epërsi mbi termat ilir dhe Iliri. Meqenëse burimet disponuese kishtarë për shekullin e XI janë të pakta e pamë të arsyeshme t’u referohemi dhe burimeve të shekullit pasues. Në funksion të objektit në studim vijnë të dhënat e natyrës kishtarë që i përkasin vitit 1166⁶⁸, kur gjatë shugurimit të kishës së Shën Trifonit në Kotorr ishte pjesëmarrës edhe peshkopi i Arbërit (*Lazarus Arbanensis*)⁶⁹. Në të ishte i pranishëm edhe i pari i arbërit, Andrea (*Andreas*

⁶⁶ *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë (shek.VIII-XV)*, vëll. II, Tiranë: 1962, f.331; M.Barletitus, *Historia de vita...*, lib.I, f. 2-5; sipas *Burime të zgjedhura...*, f.276; J.Radonic, *Gjuragj Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, Beograd: 1942, f.248; P.Bartl, *Shqipëria nga mësjeta deri sot*, Prizren: 1999, f.48.

⁶⁷ Shaban Demiraj, *Emërtimi i shqiptarëve ndër shekuj...*, f. 84.

⁶⁸ K. Frashëri, “Trojet shqiptare...”, f. 202.

⁶⁹ L. Smiciklas, *Kodex Diplomaticus Regni Croatiae*, vëll. II, Zagrabriae: 1904, f. 102, 110; M. Sufflay, *Acta et Diplomata res Albanie mediae eatatis illustrantia*, vol. I, Vindobonae, 1913, dok. 93, 97; Sipas Pëllumb Xhufi, “Krishtërimi roman në Shqipëri

Arbanensis). Titulli “prior” tregon autonominë e krahinës Arbanon. Ndërsa banorët e tjerë të hapësirës gjuhësore shqipe vazhdonin të quheshin me emrin e komunitetit politik ku bënin pjesë. Nga bizantinët quheshin: romaios, boulgaroi, sklavinioi, ndërsa nga latinët quheshin: graecus, bulgarus, sclavinus. Të dhënat e përmendura të fushës kishtare tregojnë se kisha e Arbrit po paraqitej me një status të ri. Ky status në vitin 1188 është paraqitur në “*Provinciae Vetus*”, ku peshkopi i Arbërit rreshtohet midis drejtuesve të tjerë të kishës shqiptaro dalmatine dhe ç’është më kryesorja, me lidhje direkte me selinë e shenjtë (*ed consecrationem Romani Pontificis pertinens*)⁷⁰.

Burimet kishtare rreth paraqitjes së parë të shqiptarëve dhe kufijtë e shtrirjes së tyre vijnë edhe nga perëndimi. Midis tyre duhet veçuar një grup letrash papnore që datojnë vitet 1317-1320 dhe në fillim të viteve 50 të këtij shekulli, në të cilat përmendet pothuajse gjithmonë *Regnum Albania* (Mbretëria e Shqipërisë), sikundër përmenden Ndre Muzaka, marshall i mbretërisë së Albanisë (*regni Albaniae marescalo*), Theodor Muzaka, protosevaston i mbretërisë së Albanisë, Pal Matranga dhe banorët e tjerë të mbretërisë së Albanisë (*centrisque baronibus regni Albaniae*) etj.

Për sa i përket hapësirës së banuar prej shqiptarëve në studimet historiografike janë hedhur mendime të ndryshme. Pikëpamjet e shprehura nga studiuesit e ndryshëm, ndonëse nuk përputhen plotësisht njëra me tjetrën, ato i bashkon ideja e përbashkët se Arbanoni në shek. e XI shtrihej në lindje të Durrësit e në perëndim të Ohrit, duke përfshirë brenda saj edhe bërthamën fillestare, ku gjeografi aleksandrian Ptolemeu në shekullin e dytë vendoste fisin ilir të albanëve me kryeqendër Albanopolin. Studiuesi Konidharis, duke përgjithësuar mendimin e disa autorëve të tjerë iu përmbajt pikëpamjes se albanët ishin përqendruar në një zonë malore që shtrihej “në katërkëndëshin midis Shkodrës, Durrësit, Ohrit dhe Prizrenit”⁷¹ ndërsa K. Jireçek thekson se “në mesjetë banimet kryesore gjendeshin në katërkëndëshin Shkodër, Prizren, Ohër dhe Vlorë me zgjatime tej për në veri”⁷².

Pra, në këto studime pranohet shfaqja e shqiptarëve në shekullin e XI, por ngushtojnë së tepërmi shtrirjen hapësinore të tyre. Si epiqendër të vendosjes së tyre konsiderohet krahina e Krujës⁷³. Territori shqiptar i kësaj kohe, por dhe i dy-tre shekujve që pasuan nuk ishte i lidhur me ndonjë formacion politik,

në shekujt VI-XVI”, në *Krishtërimi ndër shqiptarë* (Simpozium Ndërkombëtar), Shkodër, 2000, f. 93.

⁷⁰ P. Xhufi, “Krishtërimi roman...”, f. 94; M. Sufflay, *vep. e përm.*, dok. 200.

⁷¹ *AIH*, A.II.64, J. Konidharis, *burim i përm.*, f. 7.

⁷² *Po aty*, A.III.118, K. Jireçek, “Shënime mbi Shqipërinë”, fl.6.

⁷³ *Po aty*, A.III.111, Ivan Bozhiç, “Shqipëria dhe shqiptarët në shek. XIII, XIV, XV”, fl. 2.

kufijtë e të cilit të përputheshin me kufijtë e territorit të banuar nga shqiptarët. Shtrirja e këtij territori përcaktohej vetëm nga shtrirja e etnisë shqiptare.

Sipas Shufflait Shqipëria e këtij shekulli ishte “një krahinë e vogël, me qendër fortesën e Krujës” dhe kapte hapësirën “përreth dhe ndërmjet boshteve të mëdhenj Dyrrachian-Dibër dhe Durrachian-Ohër”, që ai e konsideron një “nyje malore tepër të egër”⁷⁴. Pak a shumë këtë shtrirje u jepte shqiptarëve të shek. XI edhe G. Shtadmyler. Ky është shprehur se “në vendin malor ndërmjet fushës së Shqipërisë së ulët dhe luginës së Drinit të Zi gjendet Arbanoni”.

Duke e vazhduar idenë shprehet se “Arbanon duhet kërkuar në vendin malor të Shqipërisë afërsisht në vijën ndërmjet Petrelës dhe Dibrës”⁷⁵. Në trajtimin e tij mbrohet pikëpamja se ajo mbështetet kryesisht në argumente të fushës së etnografisë dhe të filologjisë, mbasi të dhënat e fushës së historisë janë tepër të papërfillshme. Si argument historik vlerësohet fakti që viset që u rezervohen shqiptarëve, nga autorët e përmendur kishin mbetur jashtë “sundimeve fqinjë”, serbe e bullgare. Këtë fakt historik e kanë vlerësuar si një provë më shumë, që krahina e përmendur “formonte strehimin e popullsisë shqiptare”⁷⁶.

Gjithsesi këtu kemi të bëjmë me bërthamën fillestare të Arbanonit. Kjo bërthamë në rrjedhën e shekujve për arsye të veprimit të faktorëve të ndryshëm do të zgjerohet vazhdimisht, në krahun jugor e verior. Në rastet kur në ndonjë trajtime Arbanonit i jepet vetëm shtrirja embrionale, shpjegohet me atë se autori apo autorët kanë operuar vetëm me dokumentacionin historik të shek. XI. Kështu duhet trajtuar ideja e prezantuar në një paraqitje që është bërë për princërit e Janinës në mesjetën paraosmane, në revistën “Dituria”. Në të thuhet se Arbanoni shtrihej në hapësirën “midis Krujës, Durrësit dhe Elbasanit”⁷⁷.

Përgjithësisht, pikëpamja që i jep arbërve një shtrirje të vogël dhe kryesisht në zonat malore, nuk ka gjetur mbështetje në mendimin historiografik. A. Dycellier gjatë interpretimit të të dhënave të Attaliatë tërheq vëmendjen se “një popull i tërhequr në krahinat e egra...si mund të jepte elementë aq të qytetëruar sa të shikohej i barabartë me latinët e Italisë bizantine dhe me vetë bizantët”⁷⁸.

Kësaj teze i adresoi kritika Dycellier. Sipas tij, krahina që quhej truall i shqiptarëve në shekujt XI ishte “e papërshtatshme dhe zhveshur nga tokat

⁷⁴ *Po aty*, A.II.67, A. Ducelier, *burim i për.*, fl. 2

⁷⁵ *Po aty*, A.II.62, G. Stadtmüller, “Hulumtime për historinë e hershme të Shqipërisë”, f. 400-401; *po aty*, A.II.67, A. Ducelier, *burim i për.*, fl. 2.

⁷⁶ *Po aty*, A.II.67, A. Ducelier, *burim i për.*, fl. 2.

⁷⁷ Theodor Ippen, *Dy shekull e gjysmë nga histori e Shqipërisë*, Tiranë: “Dituria”, vol.III, 1927/28, Nr. 12.

⁷⁸ *AIH*, A.II.67, A. Ducelier, *burim i për.*, fl. 5.

pjellore” dhe si e tillë “nuk paraqiste asnjë interes”, prandaj “nuk është e habitshme që grekët dhe sllavët nuk kanë hyrë në këtë krahinë”⁷⁹.

Grupi i autorëve me përfaqësues kryesor Shuflai - Shtatmyler mbështetet edhe tek toponimia sllave e cila në zonën malore të Matit e rreth saj është shumë e kufizuar. Edhe ky argument i është nënshtruar kritikës nga A. Dycellier⁸⁰. Mbështetur në argumente historike është trajtuar pikëpamja se vala e dyndjes sllave u shtri ngadalë si në Greqi, ashtu dhe në Shqipëri. Ajo, në shumë raste shmangu depërtimet në zonat e vështira. Këto zona krijuan “ishuj jo sllavë”. Fakti që sllavët pushtuan kryesisht zonat fushore-kodrinore (ku toponimia sllave është më e pranishme) është një argument “që *Arbanoni i shekullit të XI, formonte një territor më të gjerë* (nënvizimi ynë) dhe që shqiptarët në vend që të tërhiqeshin në një nga rajonet më të padepërtueshëm të vendit, mbanin prej kohësh marrëdhënie me pushtuesit e tjerë të domenit të tyre dhe veçanërisht me bizantinët”. Në favor të tezës që u jep arbanëve një shtrirje dhe në zonat fushore është rreshtuar dhe historiani Kostantin Jireçek. Ai është shprehur se “Arbanasit banonin fushat e viset malore” dhe i quan ata “banorë autokton”⁸¹.

Një përpjekje për tu vlerësuar dhe që lidhet me përcaktimin e shtrirjes së Arbanonit në shek. XI është mbështetur kryesisht në burimet bizantine që i përkasin periudhës së sulmit të parë norman në tokat shqiptare. Mbështetur në interpretimin e këtyre burimeve në mendimin historiografik është hedhur pikëpamja se emërtimi Arbanon qysh në shekullin e XI përfshinte edhe qytetin e Durrësit. Dycellier përvetësoi pikëpamjen e Shtatmylerit, i cili “sheh tek Arbanitët një nga elementët që popullonin atëherë rrethinat e Durrësit” dhe për të “nuk është më e nevojshme t’i lokalizojmë arbanitët në pjesën veriore të vendit, nën pretekstin që bullgarët sundonin në qendër dhe në jug”⁸².

Këtë përvetësim ai e mbështeti dhe në faktet historike të cilat nuk jepnin prova se “bullgarët kanë ndjekur një politikë dhune kundrejt popullsisë lokale”, sikundër asgjë nuk provohet se “disfata e perandorisë (bullgare) të ketë provokuar një shtrirje të papritur të shqiptarëve”⁸³. Studime të tjera i japin Arbanonit një shtrirje drejt jugut, që përtej qytetit të Vlorës⁸⁴. Me këtë të fundit

⁷⁹ *Po aty*, fl. 2.

⁸⁰ *Po aty*, f.3

⁸¹ *Po aty*, A.II.88, K. Jirecek, “Tema Bizantine ...”, fl. 1.

⁸² *Po aty*, A. II. 67, A. Dycellier, *burim i për.*, fl. 6.

⁸³ *Po aty*.

⁸⁴ Milan Shuflai, “Shqipëria në mesjetë”, në *EKSKLUZIVE*, nr. 23/2002, f. 93; K. Luka, “Toponimia shqiptare në këngët e Rolandit lidhur me disa ngjarje të viteve 1081-1085”, *Studime historike*, nr. 2/1967, f.127-144; *Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 1969, f. 155-161; K. Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes ...”, *Shqiptarët dhe trojet e tyre*, f. 186.

autori nënkupton termin Labëri, të cilin e konsideron si deformim të emrit Arbanon.

Pavarësisht prej tezave dhe antitezave të hedhura, rëndësi ka fakti, që shek. XI, në historiografi është vlerësuar si një “etapë vendimtare” dhe se shtrirja e emrit të Arbanonit deri në këtë periudhë ishte rrjedhojë e “një përhapje të ngadaltë që shumë mirë mund të ketë filluar që prej kohësh”⁸⁵.

Nga fundi i shekullit të XII, kur burimet bizantine bëjnë fjalë edhe për ekzistencën e një formacioni politik shqiptar të pavarur (Principata e Arbërisë), emërtimi Arbanon u shtri dhe në krahinën veriore të Pultit⁸⁶ (në kohën e sundimit të Progonit). Në kohën e sundimit të Dhimitrit ky emërtim u shtri dhe në krahun jugor në viset e Kunavisë dhe të Cernikut deri në luginën e Shkumbinit⁸⁷. Kjo shtrirje në rritje përtej kufijve të Arbanonit historik shpjegohet vetëm me përfshirjen e krahinave të përmendura më lart në komunitetin politik e fetar të arbanitëve.

Ndërsa në burimet e shek. XIII Arbanoni mori shtrirje më të gjerë. Kjo shpjegohet me faktin që Karli I Anzhu, territoret e pushtuara në Shqipëri i përfshiu në një formacion të vetëm politik me emrin “Mbretëria e Albanisë”. Brenda këtij formacioni u përfshi në territoret nga lumi Mat në Veri deri në Kaninë në Jug duke përfshirë dhe Orikun⁸⁸, nga brigjet e Adriatikut në Perëndim deri në Drinin e Zi në lindje.

“Mbretëria e Albanisë” për shkrimtarët dhe kancelarët e shek. XIII formonte një komunitet politik e fetar më vete. Sipas mentalitetit mesjetar, banorët katolikë të këtij komuniteti politik u konsideruan arbanitë (albanite), kurse banorët jokatolikë (ortodoksit) të kësaj mbretërie, pavarësisht prej gjuhës së folur quheshin “romaios” për bizantinët dhe “graecus” për anzhuinin (latinin). Kështu p.sh. kur Karli I Anzhu në vitin 1274⁸⁹ përmend togfjalëshat: “armiqtë tanë grekë” dhe “albanitë dhe grekë” (albanenses et greci) nënkupton në rastin e parë shqiptarin ortodoks, kurse në rastin e dytë shqiptarin katolik dhe ortodoks. Nuk është rastësi që në mendimin historiografik, qysh në fillim të shek. XX depërtoi ideja që me arbanit (albanit) kuptohej shqiptari katolik në tërësinë e tij⁹⁰.

⁸⁵ *AIH*, A. II, 67, A. Ducelier, *burim i përm.*, fl. 7.

⁸⁶ S. Novaković, *Zakonski Spomenici*, Beograd, 1912, f. 384; sipas K. Frashëri, “Trojet shqiptare...”, f.202.

⁸⁷ G. Akropolites, Leipzig, 1903, XIV, f.28; Sipas K. Frashëri, “Trojet shqiptare...”, f. 202.

⁸⁸ K. Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes...”, f. 137.

⁸⁹ K. Frashëri, “Trojet shqiptare...”, f. 202-203.

⁹⁰ Ch. Kohler, *Recueil des historiens des Croisades*, Paris: 1906, vol. II, f. 487; Sipas Kristo Frashëri, “Trojet shqiptare”, f. 203.

Të dhëna me interes na jep edhe një marrëveshje e Dubrovnikut⁹¹ me sunduesin e Shqipërisë në fillim të shekullit të XIII. Sipas saj në fillim të shek. të XIII⁹² një person i rëndësishëm⁹³ i quajtur Dimitri, djali i Progonovit, pas pushtimit të Kostandinopojës (1204) "... ishte i pari sundues në Krujë me rrethinat e saj në tokën shqiptare... nga e cila më vonë e merr emrin gjithë populli"⁹⁴.

Duhet vlerësuar si një marrëveshje ndërkombëtare me rëndësi të posaçme, që prijësit shqiptar bënë me një shtet më të përparuar, siç ishte Dubrovniku dhe se janë të pavarur prej P. Bizantine.

Fakti që marrëveshja përmban zhvillimin e tregtisë së lirë midis Dubrovnikut dhe vendit të sunduar nga Dhimitri tregon pavarësinë e këtij të fundit nga Perandoria Bizantine.

Sipas dokumentit del se Kruja edhe pse ishte pjesë përbërëse e Perandorisë Bizantine nuk kishte arritur të dominohej prej asaj kulture, gjë që reflektohet qartazi në stilin e të shkruarit të dokumentit⁹⁵.

Zhvillimet e shek XIII shpjegohen edhe me konceptimet e reja që filluan të shfaqen tek qarqet e ditura bizantine të Perandorisë së Nikesë, lidhur me përcaktimin e popullatave të ndryshme të perandorisë. Në këto qarqe nuk dominon më komuniteti politik e fetar, por ai lingvistik e fetar. Ishte ky konceptim i ri që dalloi brenda "romaios" banorin "helen" (shtetasin bizantin ortodoks që fliste gjuhën greke). Zhvillimi i këtij botëkuptimi çoi në dallimin e shqiptarit ortodoks nga heleni ortodoks, sepse u përkisnin dy komuniteteve gjuhësore të ndryshme. Nga ana tjetër shqiptari ortodoks dallohej nga shqiptari katolik sepse u përkisnin dy komuniteteve fetare të ndryshme. E rëndësishme

⁹¹ *AIH*, A-II-18, fl. 2. Ky dokument i përket serive të shumta të marrëveshjeve miqësore që Dubrovniku bënte me fqinjët e vet, duke filluar nga gjysma e dytë e shek. të XII. Ajo ka gjetur dritën e botimit në revistën "Archiva", nga autori Aleksandër Solovjev, Prof. në Universitetin e Beogradit, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Sociale

⁹² Sipas interpretimit që i është bërë marrëveshjes ajo është shkruar para vitit 1216.

⁹³ Ky konkluzion mbështetet edhe në faktin që Dhimitri mbante dy tituj. Njëri njihet me emrin Magnus Arhond, që përgjithësisht shqipërohet Princ i madh. Kjo terminologji ndeshet edhe në raste të tjera të kësaj periudhe, gjë që tregon se Dhimitri e ndjente veten si një sundues i pavarur.

Titulli i dytë quhej Panhypersevastos. Këtë titull e përfitonin përfaqësuesit e shtresës së katërt, kryesisht kushërinjtë e mbretërve bizantinë. Shtresat I-III ishin: despotët, qezarët, sevastokratët.

⁹⁴ *AIH*, A-II-18, "Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut me sunduesin e Shqipërisë në fillimin e shekullit XIII", fl.2; A.V. Soloviev, *Eine Urkunde des Panhypersebastos Demetrios*, f.304; shih edhe *Hylli Dritës*, viti XIV 1938, f.702; *Burime të zgjedhura ...*, vëll. II, Tiranë: 1962, f.83.

⁹⁵ *AIH*, A-II-18, *burim i përm.*, fl. 8.

është se u krijua terreni për daljen e një emri të përbashkët për gjithë shqiptarët ortodoks. Pak a shumë të njëjtën shtrirje japin edhe burimet që i përkasin fillimit të shek. XIV. Sipas një harte të publikuar prej Shuflait, shqiptarët e kësaj kohe në krahun jugor shtriheshin deri në territoret që posedonte Mentulo Muzaka në Këlcyrë, në krahun lindor deri në territoret e Ohrit dhe Dibrës, ku shtrinin zotërimin e tyre Matarangët, kurse në krahun verior deri në territoret e Blenishtëve që zotëronin Mirditën deri në Danjë dhe Ulqin. Këto territore që Shuflai i përfshin në Arbëri duhen konsideruar thjeshtë si territore të Mbretërisë së Albanisë dhe jo si territoret e Shqipërisë etnike, e cila shtrihet shumë më gjerë se kaq.

Është e rëndësishme që kjo problematikë të trajtohet edhe nga një aspekt tjetër. Sikundër përmendëm më lart në rastin e shqiptarëve që flisnin të njëjtën gjuhë dallohej shqiptari ortodoks nga ai katolik. Por, ky dallim nuk mori përmasat e rastit të kroatit katolik me serbin ortodoks, ku ndarja midis tyre ishte e formës së prerë. Kjo ndarje nuk ndodhi në rastin e shqiptarëve që u përkisnin dy përkatësive fetare sepse “në viset e banuara nga shqiptarët ortodoks nuk u krijua ndonjë komunitet politiko-fetar i veçantë që t’i kundërvihet komunitetit politiko-fetar të arbanitëve”⁹⁶.

Por, arsyeja kryesore për historiografinë shqiptare është ajo që ka konstatuar M. Shuflaj dhe që lidhet me fanatizmin fetar të shqiptarëve që “në kohën e mesme... mezi i gjendeshin gjurmët”⁹⁷. Ky konstatim do të thotë se tërësia e banorëve që flisnin gjuhën shqipe ishin të bashkuar midis tyre pavarësisht prej përkatësisë fetare ortodokse apo katolike. Ky fakt ndeshet edhe pas myslimanizmit të pjesës më të madhe të popullsisë shqiptare. Shihet qartë se në rastin e shqiptarëve dominoi komuniteti linguistik përballë dallimeve fetare. Ky dominim linguistik është konsideruar me të drejtë si faktor kryesorë i unifikimit etnik të shqiptarëve.

Edhe këtë zhvillim të ri janë shkrimtarët bizantinë që e dokumentojnë për herë të parë. E rëndësishme është se ata përdorin një emër të përbashkët për gjithë shqiptarët pavarësisht se në fillim nuk janë unifikues për të. Shkrimtari i shek. XIV, G. Gregoras i quajti ilirë⁹⁸, ndërkohë që bashkëkohësi i tij J. Kantakuzeni i quajti albanitë⁹⁹.

⁹⁶ K. Frashëri, “Trojet shqiptare ...”, f. 203.

⁹⁷ M. Sufflay, “Die Krichenzustände im Vortürkischen Albanien”, *Illyr. Alb. Forschungen*, I, 190; Sipas Kristo Frashërit, “Trojet shqiptare ...”, f. 203.

⁹⁸ N. Gregores, Bonn, V,6; XI,6; Sipas Kristo Frashërit, “Trojet shqiptare...”, f. 204.

⁹⁹ J. Kantakuzentos, Bonn, IV,43; Sipas Kristo Frashërit, “Trojet shqiptare ...”, f. 204.

Në shek. XV Chalcokandylas¹⁰⁰, Dukas¹⁰¹ dhe Sfrantz¹⁰² përdorën emrin albanitë, ndërsa Kritobulos¹⁰³ emrin ilirë. Andaj duke kaluar nëpër shekujt e mesjetës, ”të kushtëzuar nga hapësira etnike kompakte dhe faktori politik shqiptar, emërtimet gjeografike si: Arbanon, Arbëri ose Epir, i ndeshim bukur shpesh edhe jashtë kufirit të tyre administrativ, sikurse trevat e Malit të Zi e të Maqedonisë së sotme edhe të Kosovës derti te Novipazari e Nishi përfshiheshin në kuadër të konceptit Arbëri¹⁰⁴, por është e njohur se gjatë “shekujve të mesjetës, për shkaqe të faktorit të jashtëm politik, emërtimi etniko –gjeografik Arbanon, nuk përfshinte gjithëherë të gjitha trojet shqiptare, pra edhe territorin e Kosovës¹⁰⁵ dhe viset e tjera etnike.

Por koncepti i ri unifikues nuk mundi të triumfojë plotësisht gjatë shek. XV. Shumë shkrimtarë dhe shkruer të tjerë, sidomos nga bota perëndimore qëndruan të mbërthyer pas konceptit linguistik-fetar. Kjo kategori, nuk arriti të konceptonte faktin që banorët që flisnin të njëjtën gjuhë, që jetonin në të njëjtin territor, por që kishin rite të ndryshme fetare, ti përkisnin një etnie. Dëshmi të kësaj situatë janë disa akte të huaja të shek. XV që përmendin ende *albanitë* dhe *epiriotë* ose *makedonas* dhe *epiriotë*, në kuptimin e dy etnive të ndryshme¹⁰⁶.

Tërësia e pikëpamjeve dhe mendimeve të shprehura nga autorët e përmendur nga gjysma e dytë e viteve 70-të e në vazhdim nuk kanë mundur të sigurojnë qëndrueshmëri. Dalja në dritë e burimeve të reja dhe kryesisht ato bizantine tërhoqën vëmendjen e studiuesve për rishikimin e tezës për shtrirjen e arbanonit.

Njoftime interesante sjell një kronikë anonime, e përgjithësuar me emrin kronika e Tokove, që u bë e njohur për herë të parë në vitin 1958 nga Xhuzepe Skiro në Kongresin e IX të studimeve bizantine në Mynhen, si dhe në disa botime të tjera të këtij autori¹⁰⁷. Në disa fragmente të shkëputura të kësaj kronike përmendet emri “*tá alvána*” që nga pikëpamja gjuhësore i përket shumësi. Si i tillë ai është interpretuar si koncept që shpreh kuptimin etniko-gjeografik (vëndi i shqiptarëve) që rrjedh nga realiteti etnik i banorëve të vendit ku përdoret (Epir).

¹⁰⁰ L. Chalcokandylas, në K. Bozhori, *Lufta shqiptaro-turke në shek XV-Burime bizantine*, Tiranë: 1967, I, 23-24, 196-198; II, 16, 123, 277-278.

¹⁰¹ Dukas, në K. Bozhori, *Lufta shqiptaro-turke...* XV, 2; XXIII, 8; XLV, 12.

¹⁰² G. Sfrantz, në *po aty*, I, 27, 31; IV, 14, 22.

¹⁰³ Kristobulos i Imbrosit, në *po aty*, I, 14, 74; III, 1, 16.

¹⁰⁴ Jahja Drançolli, *Gjenocidi dhe aktet Gjenocidiale të pushtetit Serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndeje*, Prishtinë: “A.SH.A.K”, 1995, f. 53.

¹⁰⁵ Jahja Drançolli, “Rrënjët e Qytetërimit Iliro-Shqiptar në Kosovë”, *Buletin i F. Filozofik*, Prishtinë, f.168.

¹⁰⁶ J. Radonic, *vep. e për.*, f. 129.; K. Frashëri, “Trojet shqiptare ...”, f. 204.

¹⁰⁷ K. Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes ...”, f. 138.

Në rastin e përdorimit të termit “*tá alvána*” bëhet fjalë për vendet e banuara nga shqiptarët ndërmjet Pargës dhe Ajdonatit (Paramithisë). Në ndihmë të kësaj ideje vijnë dhe të dhënat e Joan Kantakuzeni, i cili gjatë përshkrimit të ngjarjeve të ndodhura në Epir e Akarnani në gjysmën e parë të shek. XIV përmend *Αλβανοί* edhe në Pogoniani e në Libizdë¹⁰⁸.

Shtrirja e emërtimit *Αλβανov* në jug të vijës Ohër - Vlorë nuk është një emërtim i fituar në fillimet e shek. XV por kemi të bëjmë me regjistrimin e një procesi të kryer më parë. Dëshmi në favor të këtij konkluzioni vijnë edhe nëpërmjet një dokumenti raguzian të vitit 1390¹⁰⁹, në të cilin Kosturi përfshihet brenda Arbanonit¹¹⁰. Edhe të dhënat që përfitohen nga udhëzimet kancelareske dhe që i atribuohen patrikut Nil¹¹¹ (1374-1378) lidhur me mënyrat se si duhet të motivohen korrespondencat e Patrikut me despotët e Albanonit bëhet fjalë për të gjithë despotët e Albanonit në veri e jug.

Nuk është rastësi që osmanët në vitet 1431-1432 gjatë procesit të regjistrimit të tokave të pushtuara formuan sanxhakun shqiptar (Sançak-i Arvanit), duke përfshirë brenda tij edhe tokat e Çamërisë. Mbi këtë vijë të trajtimit nuk ka mundur të rezistoi pikëpamja e hedhur nga autori bullgar J. Zaimov se Epiri sundohej nga shqiptarët por jo se ishte në shumicë me popullsi shqiptare¹¹².

Ky problem është rimarrë në trajtim edhe nga historiografia e sotme shqiptare¹¹³. Sipas saj viset shqiptare në periudhën bizantine shpesh janë përmendur me emrat administrativë. Kur përmendej Durrësi nënkuptohej si themë me shtrirje nga Tivari në Himarë, të cilat ishin njëherazi edhe territore shqiptare.

Për një trajtim sa më objektiv të burimeve duhen marrë mirë parasysh koncepti që kishin autorët e burimeve të ndryshme për përkatësinë etnike të popujve. Gjatë mesjetës ky koncept nuk ka qenë statik, por ka pësuar evolucionin e vet historik. Për shkrimtarët dhe kancelarët e mesjetës së hershme vinte në shprehje koncepti i komunitetit politik dhe ai i komunitetit fetar. Dallimet linguistike, etnografike, historike, antropologjike etj. të popullsive të ndryshme që jetonin në të njëjtin komunitet politik e fetar nuk çonin peshë.

Të gjitha popullatat që iu nënshtruan pushtetit perandorak dhe kishës ekumenike të Kostandinopojës, nuk ishin as helenë, as ilirë, as trakë, por “romaios” për bizantinët dhe “grekë” (graecus) për latinët. Po kështu popullatat që iu nënshtruan perandorisë bullgare dhe si të krishterë Patriarkut të Ohrit u

¹⁰⁸ *Po aty*, f. 139.

¹⁰⁹ *Po aty*.

¹¹⁰ Castoria in partibus Albaniae, në K.Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes...”.

¹¹¹ J. Darouzes, “Mannuel des Pittakia du XIV siècle”, *Revue des Etudes Byzantines*, 1965, f. 56-57; Sipas K. Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes...”, f. 139.

¹¹² I. Zaimov, “Bolgarskie geografiskie nazvrание b. Albanii XV” reka: *Studia Balcanica*, I, Sofie, f. 179; Sipas K. Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes ...”, f. 140.

¹¹³ P. Xhufi, “Vëzhgime mbi emrin Shqipëri dhe shqiptarë...”, f. 9.

quajtën nga lindorët dhe perëndimorët “bullgarë” (bulharoi). Praktikisht kjo do të thotë se prapa emrave “romaios” dhe “bulharoi” që përmenden në burimet historike të mesjetës së hershme si pjesëmarrës në ngjarjet politike e ushtarake përfshihet medoemos edhe shqiptari mesjetar. Ky nuk përmendet me emrin e tij etnik pasi nuk kishte as komunitet politik, as komunitet fetar të veçantë. Prandaj nuk mund të pranohet i saktë konkluzioni i historianëve J. G. Hahn¹¹⁴, G. Shtatmyler¹¹⁵ etj., që gjatë mesjetës së hershme Epirin e konsiderojnë si një trevë të banuar nga bullgarët, nga fakti se shqiptarët nuk përmenden në këto ngjarje.

S u m m a r y

THE PREZENCE AND THE EXTENSION OF THE ETHNONYM ARBËR, ARBANON IN THE BIZANTIUM

In addressing the issue of the appearance and extend of the ethnonym arbanon the historiographic studies have presented different ideas and interpretations which have had diametrically opposite conclusions. These ideas have shifted toward different viewpoints. One, would consider that the distribution of the national name Arbër (Arbëri/Albani) is closely connected with the geographical area inhabited by the Illyrians therefore later by the Albanians. While other opposing viewpoints, deny the Albanian autochthony hence the Illyrian-Arbëror interconnection. In the Albanian and foreign historiographic studies a significant amount of analysis has considered the issue of the period of time when Albanians have first appeared in the lands they inhabit even nowadays.

The group of authors who defends the viewpoint of the controversial issue as regards space and time of the appearance of the ethnonym arbanon take as a reference point the insufficient historical sources. However, if those few sources are analyzed correctly in the context of the time period and place, then they determine relatively clearly the extent, the meaning and timing of the ethnonym Arbër and the connection of this ethnonym with the Albanians. This research work by examining the scientific work of authors such as: K. Jireçek, M. Shufflay, A. Ducelier, K. Frashëri, P. Xhufi, K. Biçoku etc. notices the constant presence of the Albanian ethnos during the Middle Ages in the autochthonous territories that had a much wider ethnic extend than the Albanian political state entities and although the Arbër or Albanians are mentioned in medieval historical of the XIth Century they were constant participants in the political and military events before this before. The fact that their name is not mention does not mean non presence; instead being autochthonous and incorporated into the Byzantine structures they are hid behind the name romios or any other generalising name until the moment when they begin to form their own separate political community.

¹¹⁴ J. G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena: 1854, f. 311; Sipas K. Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes...”, f. 200.

¹¹⁵ G. Stadtmuller, *Forschungen zur Albanischen Frühgeschichte*, Archivum Europae Centro-Orientalis, Budapest VII (1941) 162; Sipas K. Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes...”, f. 200.